REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

K R Y E T A R I

Nr.5562 Prot., Maliq, më 11.10.2025

PROJEKT-VENDIM -Nr. 7

"Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë"

Bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetqeverisjen vendore"* neni 29, ligjin nr. 45/2019 *"Për Mbrojtjen Civile"*, neni 30, gërma '**gj**' dhe neni 41, pika '**2**' , VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, Kreu III pika 1- Procedura e vlerësimit të dëmeve germa *"a"* dhe *"ë"*, për rastin e rënies së zjarrit në banesën e znj. Donike Zito, banues në fshatin Strelcë, njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq;

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq:

1.Të miratojë një ndihmë financiare prej 735.000 lekë, për familjen e znj. Donike Zito, të cilës i'u dogj banesa më datën 23.09.2025 - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është *1,241.309.2* lekë *(vlera prej 50 % është **620,654.6** lekë)*. Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është ***114.000*** lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është 734,654.6 lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile si më poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	735

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit Korçë.

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më datë 11.10. 2025

5562

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e znj. Donike Zito të cilës i është djegur banesa e saj si pasojë e rënies së zjarrit në banesën e saj dy-kateshe e cila jetonte e vetme.

Në datën 23.9.2025, ora 12:30, u dogj banesa e znj. Donike Zito, banuese në fshatin Strelcë, njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma *"b"* Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 574, datë 08.10.2025 shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1,241,309.2* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **620, 654.6** lekë*). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *114.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **734,654.6** lekë.

Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e znj. Donike Zito të cilit i'u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e znj. Donike Zito të bëhet nga fondi i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën **734,654.6** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetqeverisjen vendore*", *neni 29,ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012:*

- Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R.Mara		11.10.2025
	Ll.Kotmilloshi		11.10.2025
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		11.10.2025
Përgjegjës Sektori Juridik	J. Thomo		11.10.2025
Drejtore e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		11.10.2025

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel.& Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE KRIZAVE

Maliq, më datë 11.10.2025

5562

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e znj. Donike Zito të cilës i është djegur banesa e tij si pasojë e rënies së zjarrit.

Në datën 23.9.2025, ora 12:30 u dogj banesa e znj. Donike Zito, banuese në fshatin Strelcë, Njësia Administrative Gorë, bashkia Maliq dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika1, gërma *"b"*, Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.574, datë 08.10.2025, shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1,241,309.2* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **620,654.6** lekë*).Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *114.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **734,654.6** lekë. Mbështetur në preventivat sa më sipër i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare si më poshtë:

Ti jepet një ndihmë financiare znj. Donike Zito për dëmet nga ana ndërtimore në një shumë prej ***620,654.6*** lekë, pajisje dhe orendi elektroshtëpiake në një shumë prej *114.000* lekë. Totali për t'u dëmshpërblyer është **734,654.6** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetqeverisjen vendore"neni 29, ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012;*

Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	R.Mara		11.10.2025
	Ll.Kotmillshi		11.10.2025
Përgjegjës Sektori:	S. Belishta		11.10.2025

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax: 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.____Prot. Maliq, më 09.10.2025

Procesverbal-Konstatimi

I mbajtur në datën 09.10.2025 në banesën, objekt banimi dy-katëshe te znj. Donike Zito, banuese në fshatin Strelcë, Nj. Administrative Gorë , në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr.574, datë 08.10.2025, komisioni i konstatimit të gjendjes konstatoi se në banesë pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale si dhe në orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë.

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE

1. Punime Murature
2. Punime Çatie
3. Punime Suvatimi
4. Punime Dyer/dritare
5. Punime Shtresash
6. Punime Bojatisje
7. Punime Elektrike

b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE

1- Komodinë, copë 1

2- Karrige, copë 4

3- Divanë, copë 2

4- Stof me korent, copë 1

5- Tavoline buke, cope 1

Komisioni

*1.*Stiljan Belishta _____

*2.*Ronaldo Skënderi _____

*3.*Murat Agolli _____

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më 10.10.2025

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e znj. Donike Zito, banues në fshatin Strelcë, njësia Administrative Gorë, Bashkia Maliq të cilit i'u dogj banesa më datën 23.9.2025

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi (lekë)	Shuma
1	Divanë	Copë	2	30.000	60.000
2	Komodinë	Copë	1	8.000	8.000
3	Karrige të zakonshme	Copë	4	4000	16.000
4	Tavoline buke	Copë	1	5000	5.000
5	Stof me korent	Copë	1	25.000	25.000
Totali					**114,000**

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016 dhe 2023.

Komisioni:

1-Ilirjan Islamaj

2-Marjana Zhuli

3-Rodjan Mara

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

Maliq Dt. 29.09.2025

Objekti: Rikonstruksioni i Shtepisë së Djegur
Pronari: Donike Zito
Vëndndodhja: Fshati Strelce Njesia Administrative Lozhan
Bashkia Maliq

Nr.	Nr. AN	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI	SASI	ÇMIMI	VLERA
		PUNIME MURATURE				
1		Prishje mur guri	m3	26	250.00	6,500.0
2	2.54/1	Mur guri lartësi deri 3 m me llaç të përzierM-15	m3	31	9538.91	295,706.21
3	2.64/1	Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3m, llaç të përzier M 15 (oxhak)	m3	7.6	19514.39	148,309.4
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	50	456.26	22,813.0
2	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla marseleze	m2	70	3826.7	267,869.00
3	2.203	Veshje kornize me llamarine	m2	2	1882.63	3,765.3
		PUNIME SUVATIMI				0.00
1	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	45	2806.70	126,301.5
2	2.312	Suva brenda mur guri h~4m me krah llaç të përzier M 25	m2	65	1209.73	78,632.45
		PUNIME DYER DHE DRITARE				0.0
1	3.395	Dritare duralumini plastik	m2	5	11343.48	56,717.40
2	2.388/1	FV dyer të brendshme tamburate të rimesuara	m2	4	13985.76	55,943.0
		PUNIME SHTRESASH				0.00
1	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	50	456.26	22,813.0
2	2.279	Shtrese me derrasa 2.5 cm	m2	50	2587.24	129,362.00
		PUNIME BOJATISJE				0.0
1	2.399	Sherbetosje me gelqere	m2	110	48	5,280.00
		PUNIME ELEKTRIKE				0.0
1	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1220.92	1,220.92
2	2.487	F.V.Kuti shperndarese me kapak me vida PT-2	copë	4	179.77	719.1
3	2.480/2	F,V. Tubo freksibel i bute Ø 20 ÷ 21 mm	ml	30	177.52	5,325.60
4	2.482/1	F.V. Percjelles petashuk PVC Ø 2 x 1.5mm2	ml	10	121.86	1,218.6
5	2.481/1	F.V. Percjelles bakri PVC 1.5mm	ml	60	38.99	2,339.40
6	2.481/2	F.V. Percjelles bakri PVC 2.5mm	ml	60	55.85	3,351.0
7	2.486	F.V. Portollampa normale 10A	copë	2	298.44	596.88
8	2.487/c	F.V. Kuti suport pllaket 2 modular	copë	2	321.83	643.7
9	2.485/1	F.V. Çeles ndriçimi 1P 10A 250V	copë	2	593.25	1,186.50
10	2.485/g	F.V. Priza shuko universale	copë	3	649.85	1,949.6
11	2.490/1a	F.V. Automat 2P, 220V, 10A	copë	1	1235.12	1,235.12
12	2.490/1b	F.V. Automat 2P, 220V, 16A	copë	1	1510.70	1,510.7
		SHUMA				**1,241,309.2**
		Vlera e shlyerjes se demit prej 50%				**620,654.6**

Preventivi është hartuar mbështetur në Manualet e vitit 2024

Preventivoi: Ing.Marjana ZHULI

KOMISIONI I VLERESIMIT

Ilirjan Islamaj **Marjana Zhuli** **Rodjan Mara**

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË MALIQ
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

BASHKIA MA. 2
Zyra e Protokollit
Nr. 5152 Prot.
Date 26.9.25
Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
ZYRA ME NJË NDALESË

Nr. 125 Prot. Maliq, më 24.09. 2025

ANKESË/KËRKESË

Drejtuar: BASHKISË MALIQ

Emër/Mbiemër:	- Donika Zoto
Adresa:	- Stelce
Qyteti/NJA:	- Gore
Telefon:	069 773 4655
E-mail:	

Problemi dhe ankesa që do të trajtoni:

Në datën 23.09.2025 va zjarr në borresën time. Kërkoj të pajisem me ndihmë ekonomike & financiare sepse nuk kam borresë dhe jetoj evetme. Ju lutem më ndihmoni

Bashkia Maliq	
Drejtoria që merr përsipër trajtimin e çështjes:	Sektori i Emergjencave Civile.
Personi përgjegjës:	
Verifikimi në terren:	

Nëpunësi i zyrës: **Nënshkrimi**

Emër/Mbiemër Bleona Emin

Ankuesi:

Emër/Mbiemër Donika Zoto

Afati i kthimit të përgjigjes: 10 (dhjetë) ditë kalendarike

Nëse nuk paraqitet pëgjigjigje brenda 10 (dhjetë) ditësh do të vihet në dijeni Kryetari i Bashkisë!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr.5376, Prot

Maliq, më 8.10.2025

URDHËR

Nr.574, Datë 8.10.2025

PËR
NGRITJEN E KOMISIONEVE TE KONSTATIMIT TË GJËNDJES DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E ZNJ. DONIKE ZITO, FSHATI STRELCË, NJËSIA ADMINSTRATIVE GORË"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 64 "Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë", gërma "a", Ligjit Nr. 45/2019 *"Për mbrojtjen civile"*, neni 30, gërma "gj", VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", Kreu III, pika 1 "Procedura e vlerësimit të dëmeve" germa "b", për evidentimin e gjendjes së krijuar nga rënia e zjarrit në datën 23.09.2025, në banesën e Znj. Donike Zito, Fshati Strelcë, Njësia Adminstrative Gorë,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Gjëndjes dhe Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve për evidentimin e situatës nga rënia e zjarrit në shtëpinë e Znj. Donike Zito, Fshati Strelcë, Njësia Adminstrative Gorë, me përbërje si më poshtë:

Komisioni i Konstatimit	**Komisioni i Vlerësimit**
a) Stiljan Belishta	a) Ilirjan Islamaj
b) Ronaldo Skënderi	b) Marjana Zhuli
c) Murat Agolli	c) Rodjan Mara

2. Komisionet të hartojnë proces-verbalet e konstatimit të dëmeve dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara, për tja bërë prezent Këshillit të Bashkisë.
3. Të njoftohet Sektori i Mbrojtjes Civile pranë Prefekturës së Qarkut Korçë.
4. Të plotësohet dosja përkatëse me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e problemit.
5. Për zbatimin e ketij urdhëri ngarkohen komisionet e ngritura ne pikën 1 të ketij urdhëri.
6. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI M Z SH-së

Nr.5167 Prot. Maliq, më 29/9 /2025

VËRTETIM ZJARRI

Vërtetojmë se më datën 23/09/2025 ora 12:30, në objektin,"Godinë banimi",ka rënë zjarr.

Objekti: Godinë banimi .

Me pronar z/znj Donika Zito.
Me adresë: Strelcë Njësia Administrative Gorë bashkia Maliq.
Si pasojë e zjarrit janë diegur, orienditë shtëpiake dhe çatia komplet .

Për fikjen e zjarrit kanë marrë pjesë personeli i stacionit të MZSH-së Maliq, me komandant shërbimi Kristi Xhafkollari dhe tre automjete zjarrfikëse me targë AA071UO,me targë AB096GB dhe me targë AA762VU.

Stacioni i MZSH-së disponon dokumentcionin përkatës që vërteton rënien e ketij zjarri.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe lëshohet me kërkesën e të interesuarit .

Komandanti i Shërbimit

Zjarrfikës Kristi Xhafkollari

Shefi i Sektorit MZSH-së

Kryeinspektor Zjarrfikës Sadik HALIL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Maliq

Njësia administrative Gorë

Zyra e Gjendjes Civile - 240

Date: 26.09.2025

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vertetohen të dhenat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1	Donike ZITO	Qamil	Hedije	F	[illegible]	13-06-1949	Ire ve	Strelcë, Korcë	Shqiptare	E95613107H
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

Kjo certifikatë lëshohet për _____ Dokument _____

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date 2025/09/26 09:41:20 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.28 Prot. Maliq, më 25.9.2025

Procesverbal-Verifikimi

I mbajtur në datën 25.9.2025 në banesën e znj. Donike Zito me objekt 1 katësh në fshatin Strelce, Nj. Administrative Gorë, me marrjen e njoftimit të bërë nga e dëmtuara znj. Donike Zito, banesa e të cilës u dogj me daten 23.9.2025 dhe si pasojë e rënies së zjarrit kishte dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Sa më sipër do vazhdojnë procedurat sipas ligjit nr. 45/2019 *"Për Mbrojten Civile."*

Komisioni

1-Stiljan Belishta

2-Rodjan Mara

3-Llambi Kotmilloshi